



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPËSTINA VUÇITRAN	
01 Nr. / Br	179/21
Nr. i fq. / Br. st	-12-
Data: / Datum	29.07.2021
VUSHTRRIË- VUÇITRAN	



REPUBLIKA E KOSOVË

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

**PROCES VERBAL**  
**NGA MBLEDHJA E -VI- E RREGULLT E KUVENDIT TË KOMUNËS SË**  
**VUSHTRRIË, MBAJTUR MË 24 QERSHOR 2021**

*Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë duke filluar në orën 10:20.*

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë: Abdullah Vojvoda, Agim Bregaj, Ali Januzi, Arta Ymeri, Agim Krasniqi, Basri Menxhiqi, Bahrije Ademi Murati, Fatmire Saraçi, Ermal Lahu, Fakete Dushi, Faton Shabani, Gresa Muli, Gentiana Rama, Habibe Gërxfhaliu, Ilmi Azemi, Ilir Krasniqi, Fitim Halili, Ismet Hajrizi, Kushtrim Hyseni, Hajriz Mustafa, Lorik Maxhuni, Mehdi Bejtullahu, Mejreme Ismajli, Miljan Bojković, Nasuf Aliu, Nezir Klinaku, Nurtene Çerkezi-Gyshinca, Sajdie Bajgora, Selim Rrustemi, Melihate Basholli-Latifi, Suzana Sylja, Shkëlzen Feka, Teuta Aruçi Shartari dhe Ymer Haradinaj.

**Mungoi:** Shpëtim Zhegrova.

Në fillim të mbledhjes kuvendi i Komunës së Vushtrrisë nderoi me një minutë heshtje të ndjerin Halil Mernica.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe kryetari i komunës z.Xhafer Tahiri, nënkryetari i komunës z.Afrim Namani, drejtorët e drejtorive komunale, përfaqësuesit e KFOR-it dhe zyrtar tjerë kompetent komunal.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Nasuf Aliu – kryesues i kuvendit, i cili konstatoi se në sallë janë të pranishëm 34 anëtarë të kuvendit, kuorum ky i mjaftueshëm për zhvillimin e punimeve të mbledhjes plenare dhe për marrjen e vendimeve të plotfuqishme, andaj procedoi me rendin e ditës.

**Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit**-njoftoi se në tetorin e vitit 2019, kuvendit i komunës së Vushtrrisë, në një mbledhje të jashtëzakonshme ka marrë vendim për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim me kompensim në Zonën Kadastrale Gracë, kompanisë “Emona SH.P.K dhe ”Konsorciumit Kroato-Spanjoll “Conex Trade” d.o.o, me qëllim të zhvillimit të aktivitetit ekonomik përpunimi i peshkut, në atë kohë zotimet ishin se vlera e investimit do të jetë mbi 7,000.000 € dhe do të punësohen prej 400 deri në 500 punëtor, afati i fillimit të këtij projekti ka qenë gjashtë muaj, ndërsa projekti është thënë se do të finalizohet brenda 24 muajve. Andaj tani jemi në prag që të bëhen dy vite prej së është aprovuar ky projekt dhe akoma nuk kemi fillim të punimeve e lëre më finalizim të projektit, dhe në këtë rast kërkoi nga qeveria komunale dhe kryetari i komunës që të japin informata më të detajuara lidhur me zhvillimin e këtij projekti. Po ashtu në vitin 2019 kuvendi ka aprovuar një memorandum mirëkuptimi të firmosur nga kryetaret e katër komunave Vushtrri, Obiliq, Podujevës dhe Prishtinës për rrugën që lidhë fshatrat Stanoc i

Epërm me fshatrat Breznicë-Kozaricë, Barilevë deri në fshatin Lupçë ashtu që kjo rrugë të kaloj në kompetencë të Ministrisë së Infrastrukturës ku do të bëhej rregullimi i kësaj rruge, trotuari, ndriçimi publik dhe që pastaj kjo rrugë të kaloj në mbikëqyrej të ministrisë. Andaj edhe për këtë kërkoi përgjigje nga qeveria komunale dhe kryetari i komunës.

**Melihate Basholli-Latifi, anëtare e kuvendit**-adresi shqetësimin e saj dhe të qytetarëve, dhe për këtë kërkoi përgjigje me shkrim nga kryetari i komunës lidhur me zhvillimin e projektit përgjatë Lumit "Silnica" se a janë konsultuar me ekspertet e ambientit, për faktin se shqetësimi qëndron në degradimin e natyrës në atë anë për zhvillimin e këtij projekti, aty po largohen një numër i konsiderueshëm i drunjtëve dhe për këtë duhet zhvilluar ndonjë procedurë e caktuar. Andaj aksenti i pyetjes është sa është bërë ndonjë ekspertizë dhe a ndonjë përgjigje prej ekspertëve të ambientit **Ermal Lahu, anëtar i kuvendit**- pasi përshëndeti të pranishmit, ngrit shqetësimin e tij dhe qytetarëve për shkollën në fshatin Bukosh, ku ceku se ka nevojë të shtimit të hapësirës së kësaj shkolle, për faktin se nuk ka sallë të arsimitarëve, bibliotekë dhe kabinet. Salla e arsimitarëve është shndërruar në klasë për parashkollor, ndërsa arsimitarët qëndrojnë në këmbë për shkak të mungesës së hapësirës. Lidhur me këtë ai kërkoi që në planifikimin e buxhetit për vitin vijues të futet si projekt zgjerimi i hapësirave shkollore në këtë shkollë por edhe në shkollat tjera ku identifikohen kësi lloj nevojash.

**Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit**-adresi shqetësimin e qytetarëve të lokalitetit tek objekti i ish-extras, lidhur me një veprimtari ekonomike të betonit (betonjerkë), e cila është e ndërtuar në mes ambientit që është vendbanim, lidhur me këtë ai pyeti kompetentet se kanë ndërmarr ndo një veprim për ndalimin e asaj veprimtarie.

**Berat Sadiku, drejtor i DUMM-së**-tha se Drejtoria e Urbanizimi, në saj të legjislacionit në fuqi ka kompetencën që të lëshoj leje ndërtimore për objektet e kategorisë së parë dhe të dytë. Betonjerka, gurëthyesit dhe projektet tjera të ngjashme i takojnë kategorisë së tretë dhe përgjegjëse për këto leje është Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

**Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit**-vlerësoi se në atë vendbanim ku funksionon ajo betonjerkë banimi është bërë i neveritshëm, dhe kërkoi nga komuna që të ndërmarrë hapa lidhur me këtë problem.

**Agron Përçuku, drejtor i Drejtorisë së Inspektiveve**-tha se drejtoria ka bërë inspektimin e kësaj veprimtarie ekonomike, dhe në saj të tyre del se kjo betonjerkë, ka një pëlqim mjedisor për funksionim, dhe ka aplikuar për licencë. Ai njoftoi se si rezultat i mungesës së inspektorëve mjedisor, ankesat e qytetarëve janë adresuar në Ministrinë e Mjedisit me qëllim që të merren masa adekuate.

**Hajriz Mustafa, anëtar i kuvendit**-pasi përshëndeti të pranishmit, ngrit shqetësimin e banorëve për mungesë dhe reduktime të ujit të pijes, në shumë rajone të komunës e sidomos në pjesën e qytetit përmbi rrugën magjistrale, kemi reduktime të hatashme përkatësisht nga ora 23:00 deri në ora 08:00 nuk kemi ujë të pijes.

**Afrim Namani, nënkryetar i komunës**-tha se i kemi diku katër objekte shkollore, që kanë mungesë hapësire, dhe për disa prej tyre është gjetur zgjidhja, ndërsa për disa prej tyre, është vlerësuar nga ana e ekspertëve që tu shtohet edhe një kat ashtu që të krijohen kushtet për punës dhe hapësirë e mjaftueshme.

**Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit**-pasi parashtrij pika e rendit të ditës njoftoi se dy pikat e fundit të rendit të ditës, që lidhen, me Propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës pa kompensim, kompanisë rajonale e Ujësjiellit "Mitrovica" SH.A. dhe Propozim-vendimit për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale, bien në kundërshtim me

Ligjin për Dhënin e Pronës në Shfrytëzim, pasi që prona nuk mund të jepet në shfrytëzim që nga data kur Presidentit i vendit i shpallë zgjedhjet lokale.

**Adnan Lahu, drejtor i DGJKP-së-sqaroi** se pika të cila lidhen me dhënie të pronës në shfrytëzim janë të një natyre të veçantë, ku komuna nuk po merr ndonjë përfitim direkt nga ndonjë operator ekonomik dhe kështu votimi i këtyre dy pikave është jetike për interesin qytetar. Ligji është decidiv dhe parashihet që me shpalljen e zgjedhjeve lokale, ndalohet dhënia në shfrytëzim e pronës komunale por se në rastin konkret kemi të bëjmë me një rast tjetër fare.

***Në fund të debatit për rendin e ditës, Kuvendit i Komunës së Vushtrrisë me vota “unanime” aprovoi këtë:***

## R E N D D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e rregullt e kuvendit të komunës, mbajtur më 27 maj 2021;
2. Shqyrtimi i Draft Kornizës Afatmesme (KAB) për vitet 2022-2024;
3. Shqyrtimi i Informatës rreth procedurës së legalizimit të objekteve;
4. Shqyrtimi Informatës për ndarjen e bursave dhe shpërblimet e nxënësve për vitin 2020/2021;
5. Shqyrtimi i Draft-Planit të Trashëgimisë Kulturore 2021-2023;
6. Shqyrtimi i Informatës vjetore të Ndërmarrjes regjionale të ujësjellësit “Mitrovica”;
7. Rishqyrtimi i vendimit të kuvendit të Komunës së Vushtrrisë me numër të protokollit Nr.124/21, lidhur me aprovimin e memorandumit të mirëkuptimit mes Komunës së Vushtrrisë dhe Shoqatës Bamirëse “Jetimat e Ballkanit”;
8. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për zgjatjen e afatit kohor për hartimin e hartës zonale të Komunës së Vushtrrisë;
9. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës pa kompensim, kompanisë rajonale e Ujësjellësit “Mitrovica” SH.A.;
10. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale;
11. Të ndryshme.

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e rregullt e kuvendit të komunës, mbajtur më 27 maj 2021;

***Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me vota “unanime”, aprovoi procesverbalin nga mbledhja e rregullt e kuvendit, e datës 27 maj 2021.***

2. Shqyrtimi i Draft Kornizës Afatmesme (KAB) për vitet 2022-2024;

**Mejreme Ismajli, anëtare e kuvendit**-propozoi që në kuadër të kornizës të trajtohet rruga që lidhë lagjet Ismajl, Kalludra dhe Imeri në fshatin Pantinë, pasi që e njëjta është tërësisht e shkatërruar, kjo rrugë ishte ndërtuar në vitin 2008 me participimin e banorëve dhe ka një gjatësi prej 2.5 km gjëra është 3 metra. Andaj në faqen 27 të këtij dokumenti tek riasfaltimi i rrugëve në fshatra të futet ndërtimi i kësaj rruge.

**Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit**-kërkoj që të përmirësohen disa të dhëna statistikore në këtë dokument sa i përket numrit të bizneseve por edhe disa indikator të tjerë.

**Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit**-duke ju referuar faqes 29 të KAB-it, ku ndërtimit i puseve të ujit nëpër QMF dhe AMF, ku thuhet se për vitet 2022, 2023 dhe 2024 janë planifikuar nga 15,000.00 € për secilin vit, dhe kur ta dëgjosh qeverinë komunale, e cila lavdërohet se e ka shtrirë rrjetin e ujësjellësit, atëherë shtrohet pyetja se çka na nevojitet këto puse. Dhe çështja tjetër që është bërë qesharake ndërtimi i stacionit të autobusëve.

**Xhafer Tahiri, kryetar i komunës**-tha se komuna për disa vitet radhazi ka ndarë mjetet për ndërtimin e stacionit të autobusëve, por mos realizmi i këtij projekti ka ardhur për shkak të mungesës së pronës. Trajtimi i kësaj çështje do të bëhet në kuadër të hartës zonale që do të shqyrtohen në kuvend në muajin vijuese, sipas master planit, ku parashihet vendosja e stacionit afër stacionit të trenit si stacion kryesor dhe disa nënstacioneve që do të vendosen brenda qytetit.

**Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:**

**1. Me këtë vendim aprovohet Korniza Afatmesme Buxhetore 2022-2024 e Komunës së Vushtrrisë, konform Qarkores Buxhetore 2022/01, e lëshuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve me të cilën caktohen kufijtë buxhetor të buxhetit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2022-2024.**

**2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është dokumenti me emërtimin Korniza Afatmesme Buxhetore 2022-2024 e Komunës së Vushtrrisë.**

**3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa.**

**4. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit dhe nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit.**

**3. Shqyrtimi i Informatës rreth procedurës së legalizimit të objekteve;**

**Berat Sadiku, drejtor i DUMM-së**-tha se në kuadër të legjislacionit, për shkaqe të pandemisë është zgjatuar afati për aplikim për legalizimin e objekteve, deri me datë 5 shtator 2021, andaj ftoj qytetarët që ti bëjnë aplikimet e tyre brenda këtij afati ligjor. Nëse brenda këtyre afateve nuk ata qytetar që i kanë objektet pa leje nuk aplikoj atëherë ato objekte do të futen në listën objekteve për rrënim.

**Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit**-tha se është absurd që bizneseve të cilave ju lejohet të ndërtojnë përgjatë magjistrale në hark prej 150 metra nga të dy anët, të njëjtëve të mos iu jepet certifikata e ndërtimit. Dhe kjo aq më keq kur disave në po këtë relacion iu mohet e drejta e ndërtimit.

**Ali Januzi, anëtar i kuvendit**-pyeti se në vendet ku janë shkatërruar shtëpitë nga lufta, në vendet e njëjta janë ndërtuar shtëpitë e reja, tani ky objekt i ri a duhet të legalizohet si të veprohet në këtë rast.

**Berat Sadiku, drejtor i DUMM-së**-ligji nuk bë një trajtimit të tillë veç se objektet që janë ndërtuar para vitit 2004 nuk do të paguajnë fare taksë, ndërsa ato pas viti 2004 do ti nënshtrohen pagese së taksës në procedurën e legalizimit.

**4. Shqyrtimi Informatës për ndarjen e bursave dhe shpërblimet e nxënësve për vitin 2020/2021;**

**Habibe Gërxhaliu, anëtare e kuvendit**-ceku se për kategorinë e përfituesve të bursës për fëmijët e dëshmorëve, është shpallur vetëm një bursë ndërsa kanë aplikuar dy student, ndërsa kanë përfituar dy student për këtë kërkoj sqarime.

**Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit**-tha se meqenëse kjo informatë i referohet edhe shpërblimeve për nxënës, në të nuk ceket as edhe një fjali për nxënës dhe shpërblimin e tyre. Pastaj tek drejtimin inxhinieri elektrike dhe kompjuterike janë shpallur tri bursa, kanë aplikuar tetë student, kurse bursën e ka fituar Diellza/Habib/Makiqi në vitin e tretë të studimeve me notë mesatare 8,41, kurse studentit Blerim Makiqi edhe pse e ka plotësuar kriterin për përfitimin e bursës, bursa nuk iu është ndarë pasi që ishte vëllai i Diellzës, që kishte notë më të lartë mesatare. Vlerëson se këtij studenti i është bërë e padrejtë edhe pse janë motër e vëlla, sepse kjo gjë është dashur të ceket në konkurs se nuk lejohet përfitimi i dy studentëve nga e njëjta familje. Në faqe 5 drejtimi stomatologji sipas konkursit janë shpallur tri bursa, ndërsa thuhet nuk kanë aplikuar pesë student, këtu kemi ndonjë gabim teknik i cili duhet të përmirësohet. Në drejtimin e gjeo-shkencave sipas konkursit është ndarë një burës ndërsa thuhet nuk ka aplikuar një student këto janë gabime teknike por që ja humbin kuptimin fjalive e të cila duhet përmirësuar.

**Bahrije Ademi Murati, anëtare e kuvendit**- adresoj një gabim në shqyrtimi të dokumentacionit, ku një studente dëshmi e familjarit si veteran lufte, është vlerësuar si familje me asistencë sociale. Kërkoj që kjo të përmirësohet.

**Melihate Basholli-Latifi, anëtare e kuvendit**-tha se çështja e ndarjes së bursave është zvarritur jashtëzakonisht shumë, ku ka përfunduar viti akademik dhe tashmë po përfundon edhe viti shkollor, dhe kësaj kur ja shtojmë edhe faktin se sa është e rëndësishme një bursë për student, dhe për këtë sugjeroi kjo mos të përsëritet herëve tjera. Tutje shtoi se dy student të cilët kish qenë të barabartë në plotësimin e kriterëve, ishte marrë për bazë studenti i cili kishte parashtruar më herët kërkesën për burës. Nga ai diskutim i saj kishte ardhur ideja që të rishpallet sërish konkursi, ashtu që të shfrytëzohen të gjitha mjetet për student. Pastaj përmendi fakultetin FSHMN, ku është paraparë ndarja e tri bursave dhe është ndarë vetëm një bursë. Andaj kërkoi që të gjitha mjetet që kanë tepruar tu ndahen nxënësve dhe studentëve. Duke ju referuar faqes 2 të informatës ku thuhet: Fakulteti FSHMN-Matematikë, për këtë fakultet me konkurs janë ndarë 2 bursa, ka aplikuar 1 studente të cilës nuk i është ndarë bursa sepse e ka notën mesatare nën 8.00, andaj korrigjimi i fjalisë duhet të jetë me konkurs janë paraparë të ndahen dy bursa, sepse nëse ato janë ndarë atëherë kujë i janë ndarë ato bursa, ky është gabim logjik dhe përmbajtjesor dhe assesi teknik.

**Ragbete Krasniqi, drejtoreshë e DA-së**-paraqiti sqarime duke cekur se gabimet teknike dhe tjera do të përmirësohen nga ana e drejtorisë. Pastaj shtoi se gjithsejtë kemi 126 aplikantë për burë, përfituese të bursës sipas kriterëve janë 38 student, ndërsa nga mjetet që kanë tepruar kanë përfituar bursë edhe 17 student tjerë.

**Afrim Namani, nënkryetar i komunës**-sqaroi se në konkurs, për bursa është shpallur një bursë për student të kategorisë së familjeve të Dëshmorëve, dhe në fakt nga kjo kategori kanë përfituar dy studentë. Informatën lidhur me studentet nga kjo kategori Drejtoria e Arsimit e merr rregullisht nga Shoqata e Familjeve të Dëshmorëve.

**Xhafer Tahiri, kryetar i komunës**-tha se këtë vit është dyfishuar numri i studentëve përfitues të bursës dhe shuma e mjeteve financiare është bartur nga subvencionet në zyrën e kryetarit në vlerën prej 6900 €, dhe janë shpërndarë burës për të gjithë ata që kanë aplikuar dhe që i kanë plotësuar kushtet dhe kjo është një e arritur e mirë. Po ashtu janë dhënë bursa edhe shpërblime edhe për nxënësit e shkollave të mesme. Në dizajnimin e sistemit të ri është eliminuar padrejtësia që një student që ka përfituar një bursë të marrë edhe vitin vijues me automatizëm. Ai njoftoi se 69 student

kanë përfituar bursa dhe në shkollën teknike është para tri viteve që është aplikuar drejtimi i zdrktarisë, dhe i njëjti është subvencionuar.

**Ali Januzi, anëtar i kuvendit**-pyeti se mjetet financiare nga bursa studentet a i marrin si pagë mujore apo në fund vit.

**Afrim Namani, nënkryetar i komunës**-tha se në bazë të rregullores komunale për bursa, bursa jepen njëherë në vit, në vlerë prej 400 €, për vitin akademik.

**Xhafer Tahiri, kryetar i komunës**-përsërit se bursa jepet njëherë në vit për një vit akademik, dhe qëllimi i saj është që studentët të stimulohen që vazhdojnë me sukses në studime, se kuptohet se bursa nuk i mbulon të gjitha shpenzimet e një studenti për një vit akademik.

**Melihate Basholli-Latifi, anëtare e kuvendit**-tha se shqetësimi i saj lidhur me vonesat në shpërndarjen e bursave si dhe që ato të jepen në fillim vit është i bazuar sepse ka pasur shumë raste që studentet kanë dashur të tërhiqen nga aplikimi për bursë.

**Xhafer Tahiri, kryetar i komunës**-tha se për ta marrë bursën e Universitetit, nevojiten kritere më të larta se sa për bursën komunale, ndërsa ata student që fitojnë bursë universitare nuk kanë të drejtë ta marrin edhe atë komunale. Ndërsa argumenti i tij është se bursa duhet të jepet verës si parapërgatitje për vitin akademik që fillon zakonisht me 1 tetor të vitit kalendarik.

**Melihate Basholli-Latifi, anëtare e kuvendit**-përkufizoj se krejt ato që po i deklaroi kryetari i komunës janë të rregulluara me ligje dhe rregullore, asgjë nuk tha të veçantë. Por shqetësimi i saj nuk është vetë sa për të thënë diçka, por i prekë interesat e studentëve.

**Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit**-tha se sjellja e kryetarit të komunës për tri vite rresht duke u bazuar në arrogancën e numrave e bë atë të dal shumë keq. Pastaj kryetari i komunës nuk është ai që i jep kënaqësinë anëtarit të kuvendit për të diskutuar, pasi që këtë të dejtë dhe kënaqësi ia ka dhënë qytetari i komunës. Ai i sugjeron kryetarit të komunës që të ketë sjellje të mirë me anëtarët e kuvendit.

**Xhafer Tahiri, kryetar i komunës**-tha se askush askujt në kuvend nuk ka nevojë të ia bëjë avokatin. Ai më tej vlerësoi se diskutimi i tij me anëtarin e kuvendit, është përmbajtësor me qëllimin e vetëm për të informuar qytetarët-studentët. Pasi ka marrë shumë mesazhe nga prindërit për mos informim të afati për aplikim për bursë për të cilën e vjen keq. Për kundër kësaj nuk është në rregull që të tentohet të minimizohet kontributi i komunës, për rritjen e numrit të përfituesve të burës. Lidhur me vonesat në shpërndarjen e bursave, arsyetoj se buxheti i komunës alokohet në muajin mars të çdo viti dhe nuk ka mundur që të kemi thirrje publike për burës pa u siguruar buxheti paraprakisht.

**Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit**-tha se ai nuk ka nevojë të ia bëjë avokatin askujt në kuvend, ai është anëtar i kuvendit, dhe përgjatë mandatit të tij është mundura të jap kontributin e tij në mirën qytetare dhe shtoj se fatkeqësia është se ka anëtar të kuvendit që nuk e dinë se përse qëndrojnë në kuvend d.m.th janë në kuvend vetëm sa për ta quar dorën për votim gjë të cilën ai nuk e bënë. Krejt kësaj kur ja shtojmë faktin se kryetari i komunës ka përdor arrogancën e numrave edhe duke marr anëtarë nga subjektet tjera politike duke përfshirë edhe anëtarin nga radhët e LB-së. Shprehur ndryshe nuk ka kënaqësinë që jetë prapë anëtar i kuvendit, pas kjo pozitë është shndërruar në mall që shitet e blihet.

##### 5. Shqyrtimi i Draft-Planit të Trashëgimisë Kulturore 2021-2023;

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:**

1. Me këtë vendim aprovohet Plani i Trashëgimisë Kulturore 2021-2023, i Komunës së Vushtrrisë.
2. Obligohet Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport që të ndërmerr masa për implementim të këtij plani në pajtim me autorizimet dhe përgjegjësitë ligjore duke bashkëpunuar ngushtë me institucionet publike të nivelit qendror dhe organizmat tjerë të shoqërisë civile.
3. Qëllimi i hartimit të këtij plani është të përmirësoj gjendjen e trashëgimisë kulturore dhe natyrore në komunën e Vushtrrisë, të ndihmojë në integrimin e saj efektiv në kontekstin e planifikimit urban si dhe të lehtësoj integrimin e saj në qarqet ekonomike, turistike e kulturore lokale.
4. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është dokumenti me emërtimin Plani i Trashëgimisë Kulturore 2021-2023, i Komunës së Vushtrrisë.
5. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: kryetari i komunës, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport si dhe drejtorit tjera kompetente komunale.
6. Vendimi hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.
6. Shqyrtimi i Informatës vjetore të Ndërmarrjes regjionale të ujësjellësit “Mitrovica”;

**Melihate Basholli-Latifi, anëtare e kuvendit**-tha se edhe përkundër investimeve të mëdha që janë bërë në rrjetin primar dhe sekondar, të ujësjellësit, po ashtu edhe kyçjet në ujësjellës që kanë kushtuar nga 80 € për familje, prapëseprapë qytetarët nuk janë të kënaqur, për faktin se ka mungesë të ujit. Pastaj duhet të trajtohen pusetat e kanalizimeve gjë për të cilën qytetarët kanë vazhdimisht ankesa, ku nuk kemi fare intervenime për zhbllokimin e kanalizimeve, ose intervenime me shumë vonesë. Një çështje tjetër e cila paraqitet si mjaft problematike janë edhe heqja dhe mungesa e kapakëve të pusetave që ngërthen në vete rrezik për jetë e qytetarëve. Ajo kërko që këto çështje të adresohen dhe zgjidhen ashtu që të jemi më të përgjegjshëm.

**Xhafer Tahiri, kryetar i komunës**-tha se ky raport duhet të ketë më shumë vëmendje nga anëtarët e kuvendit, pasi që ujësjellësi i afekton të gjithë qytetarët e Vushtrrisë, dhe komuna nuk fare ingerenca në këto çështje, për shkak se Kompania “Ujësjellësi” i përgjigjet Qeverisë së Kosovës. Andaj diskutimi në kuvend do të duhej të adresohet në të gjetura në këtë raport. Komuna jonë në tri vitet e fundit ka investuar në kyçjet individuale në ujësjellës, ku vetëm për një vit janë kyçur 4189 familje në rrjetin e ujësjellësit, por kjo është pak nëse fabrika nuk punon në kapacitet 24 h, dhe kjo gjithashtu është pak nëse ujësjellësi nuk intervenon në mirëmbajtjen e ujësjellësit për më shumë. Para tri viteve niveli i humbjeve në rrejt ka qenë 80% dhe kësaj nuk ka ndërmarrje që do të qëndronte me 80% humbje. Për më tepër për këtë problematikë komuna ka ngritur një taskforcë të cilës i prinë nënkryetari i komunës, dhe humbjet kanë shënuar rënie në 50% por ende nuk jemi mirë në këtë drejtim dhe akoma më shumë se gjysma e ujit nuk faturohet dhe kjo është shqetësuese dhe për këtë nuk kanë ujë banorët e Vushtrrisë. Ai tha se komuna, përkatësisht drejtoritë komunale kanë bërë një punë të jashtëzakonshme në kyçje në ujësjellës por akoma mbetet probleme në disa fshatra ku duhet të instalohen mekanizma për rritjen e shtypjes së ujit si në Smrekonicë, mendje

në fshatrat si Samdrexha, Dumnica e Epërm dhe Stanofci i Epëm duhet të instalohen baster-pompat për ta qar deri në ato vendbanime ujit, ndërsa në një pjesë të konsiderueshme të fshatrave tashmë kjo problematikë është zgjidhur. Pjesa e fshatrave Strofc, Beçuk dhe një pjesë e fshatit Druar, ka filluar projekti për ngritjen e rezervuarit të ujit dhe çështja e furnizimit do të përfundoj. Në fund ai apeloj tek anëtarët e kuvendit që ta analizojnë këtë pikë të rendit të ditës, dhe që të dalin me një rekomandim konkret e të vlefshëm se i si të vepohet.

**Hajriz Mustafa, anëtar i kuvendit**-tha se ai nuk e di se çfarë rekomandimi duhet të aprovoj kuvendi, lidhur me ujin dhe shtoi çështja e furnizimit dhe shtrimit të rrjetit të ujit është bërë demode, për shkak se kryetari i komunës del në rrejte sociale dhe deklaroi se Smrekonica është bërë me ujë dhe uji nuk është askund, kjo i bie se qytetarët janë mashtruar dhe tashmë askush nuk beson.

**Xhafer Tahiri, kryetar i komunës**-tha se ai nuk mund të mësoj asnjërin nga anëtarët e kuvendit se çfarë rekomandimi duhet nxjerr kuvendi, por se ai vetëm e shtoj këtë informatë për diskutim. Më pas ai sqaroi se çështja mos funksionimit të ndërmarrjes së Ujësjetllësit është edhe si pasoj mos pagesës së ujit nga ana e qytetarëve në veri, dhe për këtë po vuajnë edhe qytetarë e pjesëve tjera, këtë duhet ta mendoj qeveria e Kosovës, që të bëj një lloj mbulimi të këtyre humbjeve, ngjashëm sikurse tek rryma elektrike, ndryshe do të kemi problem në funksionim normal. Ndërmarrja Ujësjetllësi ka edhe probleme tjera si rezultat të mungesës dhe vjetritimit të mekanizmit punues, ku për njëzet vite ajo nuk e ka një kamion për hapjen dhe pastrimin e pusetave të kanalizimit. Ai apostrofoj problemin e fshatit Smrkonicë, ku njoftoi se uji atje shkon, por duhet që të rritet presioni i ujit nga ana e fabrikës së Ujësjetllësit, dhe kjo duhet të bëhet menjëherë, ndërsa për vendet ku uji nuk shkon sipas rënies së lirë është filluar procesi i zgjidhjes përmes baster-pompave.

**Hajriz Mustafa, anëtar i kuvendit**-tha se është vet kryetari i komunës që ka premtuar që fshati Smrekonicë do të ketë ujë, dhe më vonë del se nuk ka ujë. Ai është dashur të jetë i matur në deklarimet e tij duke thënë se nëse gjithçka shkon si duhet deri me këtë datë do të ketë ujë të pijes. Tash qytetari i atjeshëm thotë se kryetari i komunës na ka gënjyer, kur ka bërë premtime.

**Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit**-tha se më herët ka qenë praktikë që ujësjetllësi të sjellë raport në kuvend, ashtu që kuvendi ta aprovoj atë raport. Por ishte insistimi i tij që ky dokument të mos quhet raport, por informatë, kjo për faktin se aty ka të dhëna për të cilat ka hapësirë për hetim dhe të cilat nuk bien në kompetenca të komunës. Fakti që përfaqësuesit e kësaj kompanie nuk janë të pranishëm në mbledhje të kuvendit të bënte të ditur se ata fare nuk e çajnë kokën për kryetarin e komunës dhe vet komunën e Vushtrrisë. Pastaj shtoi dhe pyeti se në kohën kur kemi ndërtime të kanalizimeve, a ka marrëveshje të pranimit-dorëzimit të atij projekti, ku ujësjetllësi do të merrte për sipër obligimin për mirëmbajtjen e kanalizimeve, sepse për atë edhe paguhen nga ana e qytetarëve, kjo se ka raste kur ata arsyetohen se nuk i kanë nënë menaxhim ato kanalizime. Vlerësimi i tij ishte se kuvendi, mund të bëj rekomandim, por efekti do të jetë tepër i vogël për mot thënë zero. Ai i sugjeron Drejtorisë së Shërbimeve Publike, që merr ndonjë praktike të mirë e cila do funksiononte në komunën tonë.

**Xhafer Tahiri, kryetar i komunës**-tha se nëse i referohemi raportit del se njësia e Ujësjetllësit në Vushtrri, ka një performancë më të mirë se sa njësia e Mitrovicës dhe Skenderaj, kjo duke marrë për bazë se shkalla e faturimit në njësinë tonë është 75.89 % referuar faqes 12 të raportit. Po ashtu kemi kontrolle dhe është zvogëluar shkalla e keqpërdorimit të ujit të pijes, për vaditej të kopshteve.

**Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit**-konsideron se është mjaft e rëndësishme që të debatohet për çështjen e ujit dhe në përgjithësi për Kompaninë "Ujësjetllësi", sidomos për faktin se si Komunën e Vushtrrisë kemi bërë disa kyqje të ekonomive familjare ku numri i tyre është mbi 4000 ekonomi familjare, ndërsa deri në fund të vitit prite që ky numër të shkoj deri në 9000, andaj vlerësoi se

nëse gjithë këta konsumator iu kemi ofruar kësaj kompanie, atëherë është dashur që ndonjëri nga përfaqësuesit e saj të jetë sot prezent në këtë mbledhje të kuvendit që anëtarët e kuvendit të kenë mundësinë të diskutojnë me ta. Ajo se çka vërehet nga kjo informatë është se kemi humbje të madhe të ujit dhe humbje po ashtu sa i përket faturimit të ujit që shpenzohet, krejt këto defekte sipas mendimit të tij janë si pasojë se në krye të këtyre bordeve të kësaj kompanie vendosen persona politikë të vendosura nga qeveritë e mëhershme, dhe tash e tutje duhet të vendosen njerëz profesionist. Në këtë kontekst pyetja e tij do të ishte se cili është profesioni i këtyre anëtarëve të bordit, pasi që njëri ka kryesuesit e bordit në vitin 2019 me profesion ishte Inxh. i Blegtorisë, e dihet se çfarë njohurish ka për ndërmarrjen e Ujësjetllësit. Në fund ai vlerësoi se motoja e funksionimit të këtyre ndërmarrjeve duhet të ndryshoj jo më të përpiqemi që kompania ti zvogëloj humbjet, <por që kompania të punojë për rritjen e fitimit> e kjo do të ndodhë me qeverinë e re.

**Agim Krasniqi, anëtar i kuvendit**-tha se problemi kyç i Kompanisë “Ujësjetllësi” është mos faturimi i ujit sidomos nga banorët në veriut dhe ky është një problem njëzet vjeçar, këtë e dinë të gjithë. Ai adresoi kritika ndaj drejtorit të Shërbimeve Publike, për mos prezencën e tij i cili është dashur dhe ka pasur për obligim ta mbarshtrij këtë raport dhe të sjellë edhe tekstin e rekomandimit për efektin që dëshiron ta arrijë. Ai ceku se ka diskrepancë të lartë mes njërive sa i përket faturimit, ku Vushtrria qëndron më mirë, dhe e gëzon fakti se qytetarët janë vetëdijësuar sa i përket pagesës së ujit dhe kjo ka bërë që të rritet progresi i kësaj kompanie.

7. Rishqyrtimi i vendimit të kuvendit të Komunës së Vushtrrisë me numër të protokollit Nr.124/21, lidhur me aprovimin e memorandumit të mirëkuptimit mes Komunës së Vushtrrisë dhe Shoqatës Bamirëse “Jetimat e Ballkanit”;

**Berat Sadiku, drejtor i DUMM-së-paraqiti** sqarime sa i përket këtij propozim-vendimi, ku shtoj se preambula e vendimit është harmonizuar sipas instruksioneve të marra Ministria e Mjedisit, dhe këto ndryshime drejtoria në bashkëpunim me Sekretarinë e Kuvendit i ka inkorporuar në propozim-vendim.

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:**

1. Me këtë vendim plotësohet vendimi i kuvendit të komunës me numër të protokollit Nr.124/21 i datës 27.05.2021 lidhur me aprovimin e memorandumit të mirëkuptimit mes Komunës së Vushtrrisë, dhe Shoqatës Bamirëse “Jetimet e Ballkanit”, për financim të përbashkët të Projektit-ndërtimi i Shtëpisë për Qëndrim Ditor për të Moshuarit në Komunën e Vushtrrisë, ashtu që harmonizohet preambula e vendimit me referencat ligjore si: Ligjin Nr. 04/l-174 për Planifikimin Hapësinor, Ligjin Nr. 04/L-110 për Ndërtim, Planin Zhvillimor Komunal (PZHK) 2016-2024, sipas instruksioneve ligjore të lëshuara nga Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

2. Qëllimi i kësaj marrëveshje të mirëkuptimit është financimi i Projektit-“ndërtimi i Shtëpisë për Qëndrim Ditor për të Moshuarit në Komunën e Vushtrrisë” dhe përcaktimi i obligimeve të palëve për realizimin e këtij projekti.

**3. Autorizohet Kryetari i komunës që t'i ndërmarrë veprimet e nevojshme me qëllim të zhvillimit të bashkëpunimit, si dhe t'i marrë përsipër obligimet që burojnë nga ky dokument me qëllim të implementimit të kësaj marrëveshje të mirëkuptimit.**

**4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i komunës dhe drejtoritë tjera kompetente komunale, që kanë të bëjnë me sferën e zbatimit të dispozitave të kësaj marrëveshje.**

**5. Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.**

**8. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për zgjatjen e afatit kohor për hartimin e hartës zonale të Komunës së Vushtrrisë;**

**Berat Sadiku, drejtor i DUMM-së-sqaroi se vendimi fillestar lidhur me hartën zonale është marrë në vitin 2018, me kohëzgjatje prej dy viteve, dhe pas skadimit të këtij afati, por bëhet zgjatja edhe për 18 muaj. Tutje shtoi se lidhur me këtë projekt janë mbajtur diskutimet publik për zonën urbane dhe rurale, dhe i njëjti dokument shumë shpejt do të procedohet në ministri për ta marr pëlqimin që më pas të kemi aprovimin final nga kuvend të Hartës Zonale të Komunës.**

**Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit-kërkoi që komuna të jetë e paluhatshme dhe mos të pranoj çfarëdo kërkesë nga ana e bizneseve sa i përket vendosje së koeficienteve të ndërtimit në Hartën Zonale të Komunës.**

**Berat Sadiku, drejtor i DUMM-së-sqaroi se Ligji i Planifikimit Hapësinor dhe Ligji i Ndërtimit i ka përcaktuar kushtet e ndërtimit dhe maksimalja e koficentëve është tre (3).**

**Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:**

#### **Pika 1**

#### **Lloji i dokumentit të planifikimit hapësinor**

**Me këtë Vendim zgjatet afati kohor për hartimin e Hartës Zonale të Komunës së Vushtrrisë i përcaktuar me vendimin fillestar (nr. 255/18 – 5) të marrë më 27/09/2018 nga Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë;**

#### **Pika 2**

#### **Subjekti përgjegjës për hartim**

**Bartës i hartimit të Hartës Zonale të Komunës mbetet Autoriteti Përgjegjës Komunal për Planifikim Hapësinor (APKPH) respektivisht Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit;**

#### **Pika 3**

#### **Mjetet dhe mekanizmat e nevojshme për hartim**

**Mjetet për hartimin e dokumentit të planifikimit hapësinor sigurohen nga buxheti i Komunës së Vushtrrisë përderisa zgjatja e afatit kohor nuk e shton nevojën për mjete financiare shtesë. Dokumenti hartohet nga APKPH në bashkëpunim me drejtoritë komunale**

dhe nën mbështetjen substanciale të UN-Habitat-it bazuar në Memorandumit të Mirëkuptimit të nënshkruar mes dy palëve (datë 14/04/2018);

**Pika 4**  
**Afati i hartimit**

Afati shtesë për hartimin e Hartës Zonale të Komunës nga subjekti përgjegjës është 18 muaj (27/09/2020 – 27/03/2022) i cili i vazhdohet afatit fillestar prej 24 muajve (27/09/2018 – 27/09/2020);

**Pika 5**  
**Dispozitat tjera**

Të gjitha pikat tjera nga vendimi fillestar për hartimin e Hartës Zonale të Komunës së Vushtrrisë si: përkufizimi, qëllimi, kufiri i territorit, konsultimet publike, afati i vlefshmërisë, gjuha zyrtare, programi dhe pika 12 mbeten në fuqi.

**Pika 6**  
**Hyrja në fuqi**

Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

9. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës pa kompensim, kompanisë rajonale e Ujësjiellësit “Mitrovica” SH.A.;

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim jepet në shfrytëzim pa kompensim parcela kadastrale P-70202041-00161-0, me sipërfaqe prej 370m<sup>2</sup>, ZK-Mihaliq dhe pjesë nga parcela P-70202005-00868-0 në sipërfaqe prej 674m<sup>2</sup>, nga sipërfaqja e përgjithshme prej 3674m<sup>2</sup>, ZK Beçuk, pronë e Komunës së Vushtrrisë.

2. Paluajtshmëria e cekur në nenin 1 të këtij vendimi i jepet në shfrytëzimin pa kompensim, në afat prej 99 vitesh, Kompanisë Rajonale të Ujësjiellësit “Mitrovica” Sh.A, për ndërtimin e rezervuarit të ujit në fshatin Beçuk dhe stacionit të pompave në fshatin Mihaliq.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë.

4. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është certifikata e pronës dhe kopja e planit.

5. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.


10. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale;

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim lejohet këmbimi i pronës së paluajtshme, pjesë nga parcela kadastrale P-70202016-00939-2, në sipërfaqe prej 65 m<sup>2</sup>, nga sipërfaqja e përgjithshme prej 238m<sup>2</sup> ZK Vushtrri, pronë e Izet (Mursel) Krasniqi nga Vushtrria, me pjesën e parcelës kadastrale P-70202016-01121-1, në sipërfaqe prej 65m<sup>2</sup>, nga sipërfaqja e përgjithshme prej 7074m<sup>2</sup> ZK Vushtrri, pronë e Komunës së Vushtrrisë.
2. Këmbimi i pronave, të cekura në pikën 1 të këtij vendimi bëhet me qëllim të sigurimit të hapësirës së nevojshme për rregullimin e kanalizimit në këtë pjesë të qytetit.
3. Obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, që pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi të bëjë parcializimin e ngastrave kadastrale në sipërfaqen e cekur në pikën 1 të këtij vendimi.
4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.
5. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Mbledhja përfundoi në ora 12:05.

Bastri Duraku



---

Procesmbajtës

Nasuf Aliu



---

Kryesues i Kuvendit